

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Objektet që do të mirembahen janë të gjitha godinat e Spitalit Psikiatrik "Sadik Dinçi" Qendrat e rehabilitimit "Drita" Elbasan dhe "Jeta" Cerrik

2. Impianistika përfshin mirembajtje të:

- a. rrjeti elektrik
- b. rrjeti hidrosanitar
- c. anen ndertimore të objekteve.
- d. punime të sistemit të ngrohjes (kaldaje)



Specifikimi i Materialeve:

Materialet që do të përdoren do të jenë të reja në përputhje me standartet kombëtare e ndërkombëtare të miratuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mirembajtje e objekteve sa herë që do të njoftohet nga autoriteti kontraktor operatori ekonomik duhet të përgjigjet me kryerjen e shërbimit brenda një kohe sa më të shkurtër.

I. PUNIME NDERTIMI

Suvatimi i brendshëm në riparime

Sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin.

Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Sprucim i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim me drejtues i realizuar nga një shtresë me trashësi 2cm llaçi bastard m-25 me përmbajtje për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç gëlqereje m- 1 : 2, 0.03 m³; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin. Ne perfundim duhet te largohen te gjitha mbeturinat nga objekti.

Lyerje me bojë hidro plastike

Lyerje me bojë hidro plastike e sipërfaqeve të brendshme

Proçesi i lyerjes me bojë hidro plastike i sipërfaqeve të mureve të brendshme kalon nëpër tre faza si më poshtë:

1-Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet.

Para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me ane të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për paralyerje. Në rastet e sipërfaqeve të patinuara bëhet një pastrim i kujdesshëm i sipërfaqes. Para fillimit të proçesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen. (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

2- Paralyerja e sipërfaqes së brendshme të pastruar.

Në fillim të proçesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me vinovil të holluar (Astar plastik). Për paralyerjen bëhet përzierja e 1 kg vinovil me 2.5-3 litra ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.

Norma e përdorimit është 1 litër përzierje vinovil me ujë duhet të përdoret për 20 m² sipërfaqe.

3- Lyerja me bojë hidro plastike e sipërfaqeve të brendshme.

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës plastike e cila është e paketuar në kuti 5 litërshe. Lëngu i bojës hollonhet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje i hidhet pigmenti derisa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizioni i punimeve dhe pastaj bëhet lyerja sipërfaqes.

Lyerja bëhet me dy duar.

Norma e përdorimit është 1 litër bojë plastike e holluar duhet të përdoret për 4-5 m² sipërfaqe. Kjo normë varet ashpërsia e sipërfaqes së lyer.

Hidroizolimi i taracës

Proçesi i hidroizolimit të taracës do të kryhet në vendet e demtuara ku ka lageshti dhe rrjedhje.

Perpara fillimit të proçesit të hidroizolimit duhet që: sipërfaqja të jetë e thate, e pastruar, e niveluar me pare si në pjeset horizontale ashtu dhe në ato vertikale.

Kujdes të vecantë t'i kushtohet lidhjes së mbuleses me elementet e parapeteve për të eliminuar lageshtinë si dhe zëvendësimin e parapeteve të hequra.

Sistemim i planit aktual të pjerresive për pjeset e prishura, duke përdorur llaç çimentoje m 1:2, mbi të cilën do të realizohet: një shtresë llaç çimento me trashësi minimale 2 cm, e niveluar në mënyrë perfekte për përgatitjen e sipërfaqes ku do të vihet hidro-izoluesi.

Riberje e shtresës së suvatimit vertikal, e niveluar për vendosjen e guaines.

Shtresë hidro-izoluese, mbi sipërfaqe të thate dhe të niveluar si me sipër, duke përfshirë pjesën vertikale, trajtuar me një dorë praimerit, e përbërë nga dy membrana guaine të formuar nga një shtresë fibre prej leshi xhami e bitumi, me trashësi 3 mm secila, të vendosura në vepër me flake,

te kryqezuara mbi siperfaqe te rrafshet, te pjerrtet ose vertikale, deri poshte kopertines, perfshire mbivendosjen e lidhjeve (minimumi prej 12 cm), punet e perkohshme per te gjithë kohezgjatjen e punes, e perberë nga strukture druri ose hekuri dhe siper saj me nje pelhure te papershkrueshme ose te ngjashme per mbrojtjen nga shiu, qe do te aplikohet ne siperfaqen mbi te cilen po punohet , si dhe heqjet, spostimet, mberthimet etj., si dhe çdo detyrim tjeter te nevojshem per ti dhene fund punes ne menyre perfekte.

Shtresë mbrojtëse Llaç çimento 1:2 mbi Shtresën hidroizoluese, me trashësi minimale prej 3 cm dhe me fuga çdo 2 m ne te dy drejtimet dhe 2 cm te gjera dhe të mbushura me perzierje rërë dhe bitumi, e niveluar mire dhe e ilustruar me pluhur çimentoje duke perfshire çdo punim tjeter per ta konsideruar Shtresën mbrojtëse te perfunduar ne menyre perfekte.

Sistemimi i oxhakut duke perfshire çdo detyrim dhe mjeshteri.

Ne perfundim te procesit te hidroizolimit, te pastrohen mbeturinat si ne tarace ashtu dhe ne objekt.

Shtrese pllaka

Riparimi për pllakat e dëmtuara ose për ato pllaka që mungojnë, të bëhet në këtë mënyrë:

Pllakat e dëmtuara duhen hequr megjithë llaçin në një trashësi të paktën 2 cm. Pastaj duhet që vendi të pastrohet dhe të lahet me ujë me presion. Pllakat e reja të jenë dhe me dimensione të njëjta si pllakat e vjetra dhe të vendosen në llaçin e shtruar. Llaçi për riparim duhet të përgatitet me përmbajtje: për 1,02 m² pllaka nevojiten 0,02 m³ llaç të tipit m-15 me 4 kg çimento (marka 400).

Pastaj, duhet që fugat të mbushen me masën përkatëse (bojak), të pastrohen dhe të kryhen të gjitha punët e tjera.

Pllakat do të jene gres porcelanato nje brumeshe, luçidato, cilesine e pllakes qe gjendet ne objekt. Pllakat do të jene cilesore importi, sipas standarteve europiane. Pllakat do të shtrohen me kolle, mbi nje siperfaqe grezo me llaç çimento.

Punime te tjera

Ne fv dyert druri perfshihet cmontimi i mbetjeve ekzistuese, montimi i deres se re, drejtim suvatim i shpatullave te murit.

Ne riparimin dritaret d/alumin dhe plastike do te zevendesohen dorezat e demtuara, menteshat, nderrim i kornizave e profileve te demtuara te dritareve duroalumin, riparime te tjera deri ne kryerjen perfekte te punes.

Ne riparim dyert duroalumin te zevendesohen pjeset e demtuara, ngritjen e dyerve qe kane krijuar varje dhe mezi hapen e mbyllen.

Ne riparim dyert e drurit, te riparohen kasat pjeset e demtuara, zevendesimi i tyre,menteshat.

Ndriculesit e neonit 60x60 cm me llampa neon 4 cope x 18w te jene cilesore te kapen mire pas tavanit dhe te lidhen me energji nga celesi i ndezjes

Celsa ndricimi (shuko) te jene cilesore.

PUNIMET HIDRAULIKE

Punimet hidraulike, riparimet e ndryshme hidraulike, duhet te jene te plota nga te gjitha pikpamjet e montimit dhe te cilesise te materialeve, punime qe do te realizohen nen mbikqyrjen e perfaqesuesit te investitorit. Montimi i pjeseve do te perfshije dhe furnizimin me uje per te gjithë

elementet hidraulike. Pas perfundimit te punimeve te behen provat e ujit me ngarkese nga ana e zbatuesit ne objekt ne prani te perfaqesuesit te investitorit, te caktuar per ndjekjen e kontrollin e materialeve dhe punimeve.

Materialet te jene te shoqeruara me dokumentacionin perkates, ku te evidentohen parametrat Punimet hidraulike te kryhen me mallra te komunitetit europian, cilesore, duhet te jene te shoqeruara me dokumentacionin perkates, ku te evidentohen parametrat teknike, menyra e perdorimit, garancia nga fabrika prodhuese. Per cdo vendosje paisjeje, te merret miratimi i perfaqesuesit te investitorit, te caktuar per ndjekjen e kontrollin e materialeve dhe punimeve.

Punimet duhen te kryhen me cilesi te larte per te eleminuar rrjedhjet e ujit. Materialet duhet te sigurojne percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj goditjeve mekanike, te kene mbrojtje te larte izoluese ndaj ujrave, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtësi perdorimi gjate punes dhe mundesi te thjeshta riparimi.

Materialet te jene me te njejtat parametra , cilesi dhe permasa me ato qe jane ne objekt.

PUNIMET ELEKTRIKE

Per cdo punim elektrik qe do te kryhet do te vihet ne dijeni personeli perkates dhe administrata per te mos shkaktuar deme ne pajisjet kompjuterike dhe deme njerezore, duhet te marre masat e Sigurimit Teknik per te lejuar punime pa rrezik ne tension TU (220/380V).

Zevendesimi i automateve, celesave, prizave, kutive, kablllove, percjellsave, llampave e ndricesve, etj te demtuara do te kryhet me materiale te te njejtave parametra teknike me ato ekzistues.

Zevendesimi I llampave te djegura ne ndricues inkandeshent do te behet me llampa ekonomike (compact fluorescent lamp – energy saving) me xokol E27. Gjithashtu eshte parashikuar dhe zevendesimi i llampave te djegura, te montuara ne ndricues me llampa fluoreshente lineare me xokol G23 dhe sipas rastit edhe zevendesimi i droselit e starterit.

Materialet dhe aparatet qe duhet te perdoren duhet te kenë te gjitha cilësitë e fortësisë, kohëzgjatjes, izolimit dhe të funksionimit të mirë; dhe duhet gjithashtu të jenë të tilla që t'i rezistojnë veprimeve mekanike, gërryese, termike dhe lagështirës për ato që duhet të jenë në kontakt me të gjatë punës. Gjithashtu, janë nën përgjegjësinë e sipërmarrësit montimet dhe çmontimet përkatëse të pjesëve të instalimit për realizimin e provave dhe të verifikimeve.

Te gjitha kutite e prizave ose celesave etj., duhet të vendosen në objekt nëpërmjet kutive të instaluar me llaç çimentoje m - 1.2, duke u kujdesur veçanërisht që instalimi i kutive të mësipërme të bëhet rrafsh me murin në lidhje me sipërfaqet e suvatuara dhe të veshura, në mënyrë që të mos verifikohen dalje apo futje të tepërta të këtyre kutive.

Tubi fleksibël duhet të jetë i ndërfutur në kutitë që përmbajnë celesat ose prizat, që në asnjë mënyrë të mos dëmtojnë percjellesit që hyjnë në kuti.

Ndriçuesit duhen fiksuar me siguri në tavanin ambienteve, të varur ose direkt në sipërfaqen e tavanit sipas llojit të ndriçuesit dhe të rekomandimit të dhëna nga prodhuesi.

Autoriteti Kontrator do te skualifikoj te gjithe operatoret qe kane paraqitur vlerat e zerave te lartpermendur ne kundershtim me legjislacionin ne fuqi.

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Sherbimet qe do te kryhen sipas nevojave qe do te dalin gjate punes se perditshme. Materialet dhe pjeset qe jane percaktuar ne liste jane nje parashikim i perafert dhe perdorimi i tyre do te varet nga difektet faktike qe do te ndodhin.

Sherbimi do te kryhet menjehere me marrjen e njoftimit(urdherit te punes nga shefi i hotelerise) brenda orarit zyrtar si dhe jashte tij kur gjykohe e nevojshme, per ato sherbime qe nuk presin, pasi krijojne crregullime ne aktivitetin e perditshem spitalor.Per mbulimin e nevojave emergjente qe ka profili i ketij spitali kerkojme qe firma kontraktuese te lere ne sherbim dy punonjes hidraulik dhe dy punonjes elektrikist per spitalin tone.

Kontraktuesi duhet te kryeje sherbimin ne nje kohe sa me te shkurter dhe ne prani te perfaqshuesit te spitalit.

Shperndarja: Objektet dhe pajisjet qe do te mirembahen jane ne territorit e Spitalit Psikiatrik "Sadik Dinçi" Elbasan, Qendrat e rehabilitimit "Drita" Elbasan, Qendra "Jeta" Cerrik.

Vendi dhe dorezimi i sherbimeve:

Vendi ku do te kryhet sherbimi eshte Spitali Psikiatrik "Sadik Dinçi" Elbasan, Qendrat e rehabilitimit "Drita" Elbasan, Qendra "Jeta" Cerrik ne te gjithe ambjentet e tyre.

PREVENTIV TENDER 2017

NR.MAN.	PUNIMET	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLERA	AFATI
	RIPARIME BANJO					
2.70/2	Mur me tulle te lehtesuara dopio deri 3m me llaç perzier M25	m3	1.2			
2.41	Prishje suva muri	m ²	10			
2.262/3	Shtrese betoni C 12/15	m3	2.4			
2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama	m2	15			
2.264	Shtrese lluster çimento 1:2	m2	8.25			
2.310	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25	m2	10			
2.491/a	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, PN 25	ml	15			
2.519	Tub kanalizimi pvc Ø 90 mm	ml	12			

2.520	Tub kanalizimi pvc Ø 110 mm	ml	8			
2.494	F.V saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm	cope	1			
2.481/2	F.V percjelles PV 500 Ø 2.5 m ²	ml	12			
480/2	F.V tub plastmasi Ø 18 ~ 21 mm	ml	18			
2.481/1	F.V percjelles PV 500 Ø 1.5 m ²	ml	12			
2.485/2	F.V Çeles 1 polar 220V 10A "Gevis"	cope	1			
2.485	F.V Çelesa e priza 10 A me nulifikim	cope	1			
2. a-137	Ndricues fluoreshent 4x18w,IP40	cope	1			
2.490/2	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A, dl=0.03A	cope	1			
2.326	Veshje me pllake majolike	m2	15			
2.267/a	Shtrese me pllaka grez porcelanato	m2	7.5			
2.501	F.V WC allafrenga importi	cope	1			
2.506	F.V bide importi porcelani	cope	1			
2.495	F.V lavaman porcelani importi me mishelator	cope	1			
An	Meremetim e stukim suvaje ekzistuese mure e tavane	m ²	15			
2.404	Lyerje mure e tavane me boje hidroplastike	m2	30			
2.325	F.V pllakamermeri	m ²	0.5			
2.395/a	Dere d/alumini pa xham,me mbushje d/a.	m2	1.5			
2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	2.2			
shuma I						
DHOMA KALDAISTIT						
2.1	Germim dheu me krah e transport me k dore 10 m, kategoria III	m3	3.5			
2.109/2	Themel e xokol betoni C - 12/15	m3	3			
2.258	Nenshtrese zhavori	m3	12			
2.262	Shtrese betoni C 6/10	m3	6			
2.117/1	Kollona b/a monolite C - 16/20, h ~ 4 m	m3	0.6			
2.119/1	Trare e arkitrare b/a C - 16/20, h ~ 4 m	m3	0.72			

2.70/2	Mur me tulle te lehtesuara dopio deri 3m me llaç perzier M25	m3	4.2			
2.125	Soleta b/a monolite me tulla me 6 vrima, Hd = 6m, trashesi 25cm C 12/15	m2	8.96			
2.262/3	Shtrese betoni per pjerresi C 12/15	m3	2.2			
2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama	m2	10.5			
2.264	Shtrese lluster çimento 1:2	m2	8.25			
2.203	Veshje kornize llamarine xingat	m2	8.5			
2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm	ml	3.2			
2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33 cm	ml	10			
2.300	Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah	m2	6			
2.310	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25	m2	30			
2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m	m2	25			
480/2	F.V tub plastmasi Ø 18 ~ 21 mm	ml	10			
2.481/1	F.V percjelles PV 500 Ø 1.5 m ²	ml	12			
2.485/2	F.V Çeles 1 polar 220V 10A "Gevis"	cope	1			
2.485	F.V Çelesa e priza 10 A me nulifikim	cope	1			
2. a-137	Ndricues fluoreshent 4x18w,IP40	cope	1			
2.490/2	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A, dl=0.03A	cope	1			
2.267/a	Shtrese me pllaka grez porcelanato	m2	6			
2.324a	Plintuse pllake grez	ml	9			
2.404	Iyerje mure e tavane me boje hidroplastike	m2	30			
2.390/1	F.V dyer metalike me llamarine te zeze 27.75 kg/m ²	m2	2			
2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	3.5			
	shuma II					
	PUNIME ELEKTRIKE					
An	F.v. llampa ekonomike 15-25w	cope	600			
An	F.v.llampa prozhektori	cope	20			
An	f.v starter prozhektori	cope	20			
An	f.v drozel prozhektori	cope	20			
An	F.v llampa neonI 220v 18-36w te gjata	cope	200			
An	F.v llampa neoni 60x60 cm 220v 18-36w	cope	900			
An	f.v starter 36w	cope	900			

An	F.v. drozel 36w	cope	900			
2.490/1e	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A	cope	10			
2.490/1c	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A	cope	10			
2.490/1d	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 40A	cope	10			
2.490/1b	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A	cope	5			
2.486	F.V Portollampa normale 10 A	cope	100			
2.485/7	F.V Çeles rregullator 220V 10A "Gevis"	cope	8			
2.485/g	F.V priza shuko brenda murit 2 fazore 25 A "Gevis"	cope	50			
2.485/5	F.V Çeles 2 polar 220V 10A "Gevis"	cope	50			
2. a-137	Ndricues fluoreshent 4x18w,IP40	cope	30			
	shuma III					
	PUNIME HIDRAULIKE					
An - 10	F.V Saraçineske PPR 3/4"	cope	20			
an	F.V Saraçineske PPR 1"	cope	20			
An	F.v rezistence dushi me llampe	cope	20			
An	F.v termostat dushi 20w	cope	20			
An	Fv rubineta uji 1/2	cope	100			
An	F.v tubo fleksibel 1/2	cope	149			
An	F.v sifon lavamani	cope	100			
An	F.v xham me rrjete	m2	900			
An	F.v grup dushi	cope	30			
An	F.v. grup bideje	cope	10			
An	F.v kundralvol dushi	cope	8			
An	F.v grup mishelator per lavamane	cope	20			
An	Çbllokime wc	cope	400			
An	Çbllokime lavamane	cope	250			
An	Çbllokime puseta te jashtme e brendshme	cope	250			
An	F.v sifon wc Ø110	cope	50			
An	F.v grup lavamani qafegjel	cope	70			
An	F.v boljere 80 litra	cope	1			
An	f.v telefon dushi komplet	cope	20			
An	F.v pilete dysHEMEJE Ø 100 mm	cope	19			
2.495	F.V lavaman porcelani importi me mishelator	cope	4			
An	Mini saracineske 1/2'	cope	100			

Shuma IV						
	PUNIME RIPARIMI LINJA UJESJELLJESI					
3.87/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3	149			
An 153	F.V Tuba e rakorderi PPR Pn 16 f = 50 mm	ml	200			
2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	3			
An.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	141			
Shuma V						
	PUNIME RIPARIMI DYER E DRITARE					
An	F.v brave ne porte druri komplet	cope	100			
An	F.v brave ne porte duroalumini komplet	cope	100			
An	Riparim dere druri	m2	100			
An	Riparim dere duroalumini	m2	100			
An	Riparim dritare duroalumini	m2	300			
An	Blerje drynash	cope	50			
Shuma VI						
	SHUMA I+II+III+IV+V+VI					
	T.V.SH 20 %					
	Shuma Totale					

Afatet e ekzekutimit:

Nga data e nenskrimit te kontrates deri 31/12/2017.

TERMAT E REFERENCËS

Objektet qe do te mirembahen jane te gjitha godinat e Spitalit Psikiatrik "Sadik Dinçi" Qendrat e rehabilitimit "Drita" Elbasan dhe "Jeta" Cerrik

Qellimi i sherbimeve eshte te behet riparimi dhe mirmbajtja e objekteve ndertimore dhe impiantistikes se godinave ne menyre qe te mos nderpritet normaliteti i aktivitetit spitalor.

Detyrat:

1. Kontraktuesi duhet te jete i gatshem per kryerjen e sherbimit dhe mbulimin e difekteve ne cdo kohe duke arritur mbylljen e riparimit ne nje kohe sa me te shkurter.
2. Matetrialet qe do te perdoren duhet te jene cilesore dhe te kene jetegjatesi ne pune, jene ne perputhje me specifikimet teknike (dokument tenderi), cilësore, të kenë jetëgjatësi në punë. Zëvendësimi i elementeve/ pajisjeve të dëmtuara do të kryhet me materiale të të njëjtave parametra teknike me ato ekzistues.
3. Sherbimet qe do te kryhen te jene cilesore dhe do te behen ne prezenca te perfaqsesit te spitalit.
4. Cdo riparim apo sherbim do te dokumentohet me proces-verbalin perkates.
5. Ne periudha mujore do te perpilohet situacion per kryerjen e punimeve e sherbimeve,te cilat do te sherbejne si baze per faturimin dhe likujdimin.
6. Perfaqsesit e firmes do te marrin urdherin e punes per kryerjen e punimeve per zerat perkates sipas kontrates nga shefi i hotelerise.
7. Per cdo problem te lindur gjate sherbimit te njoftohet Drejtoria e Spitalit Psikiatrik "Sadik Dinçi" Elbasan

